



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
MINISTRI

Nr. 12742/12 prot.

Data: 13. 11. 2024

VENDIM

Nr. 72, Datë 13. 11. 2024

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; në urdhrin nr. 128, datë 6.7.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e ofruesit të AFP-së, me të dhëna si më poshtë:

1. Emri i ofruesit të AFP-së: Shkolla e Mesme Profesionale "Kolin Gjoka", Lezhë
2. Akti zyrtar i themelimit/licencimit: L57527591K.
3. Organizimi i institucionit: Shkollë e mesme profesionale publike
4. Lloji i ofruesit të AFP-së: Shkollë e mesme profesionale
5. Nipti: L57527591K.

Pasi mora në shqyrtim dokumentacionin e vetëvlerësimit, raportin e vetëvlerësimit, dokumentacionin e vlerësimit të jashtëm, raportin e vlerësimit të jashtëm për akreditim, si dhe të gjithë procedurën e akreditimit të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK),

konstatoj se:

- a. procedura dhe procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditim janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara nga AKAFPK-ja për këtë proces;
- b. vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në dokumentacionin e vetëvlerësimit, vlerësimin e jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në terren;
- c. raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm,

VENDOS:

1. Akreditimin e plotë për kualifikimet profesionale:

- a) "Hoteleri-turizëm", Niveli II i KSHK-së, G-II-22,
- b) "Kuzhinë-pastiçeri", Niveli III i KSHK-së, G2-III-22,
- c) "Shërbime udhëtimi dhe turizmi", Niveli IV i KSHK-së, G6-IV-18,
- d) "Hoteleri-turizëm", Niveli IV i KSHK-së, G-IV-20,
- e) "Teknologji Ushqimore", Niveli II i KSHK-së, A-II-21,
- f) "Teknologji e përpunimit të brumërave", Niveli III i KSHK-së, A1-III-22,
- g) "Teknologji Ushqimore", Niveli IV i KSHK-së, A-IV-23,
- h) "Ekonomi Biznes", Niveli II i KSHK-së, L-II-21,
- i) "Tregti", Niveli IV i KSHK-së, L6-IV-23,
- j) "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", Niveli II i KSHK-së T-II-19,
- k) "Zhvillim Website", Niveli IV i KSHK-së, T3-IV-21,
- l) "Multimedia", Niveli IV i KSHK-së, T5-IV-21,
- m) "Shërbime Sociale dhe Shëndetësore", Niveli II i KSHK-së, O-II-22,
- n) "Shërbimi Kujdesi për Fëmijë", Niveli III i KSHK-së, O2-III-20,
- o) "Shërbime Sociale dhe Shëndetësore", Niveli IV i KSHK-së, O-IV-21,

Në përputhje me propozimin përkatës nr.153/4, datë 15.10.2024, dërguar nga AKAFPK-ja (bashkëlidhur këtij urdhri):

2. Ofruesi i AFP-së t'i nënshtrohet vlerësimit dhe akreditimit periodik institucional sipas kësaj rregulloreje, çdo 4 vjet.

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendim, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

